

Politika e Informimit dhe Transparencës

Qëlimi i Politikës

Kjo Politikë e Informimit dhe Transparencës e përgatitur në përputhje me Ligjin “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Mbi transparencën për bankingun, produktet financiare dhe shërbimet” të Bankës së Shqipërisë dhe legjislacionit në përgjithësi, synon të sigurojë informacion korrekt, të saktë, të plotë, lehtësisht të arritshëm dhe të kuptueshëm për aksionarët e Bankës, investitorët dhe të gjithë përfituesit e tjerë duke përfshirë publikun, dhe është në përputhje të plotë me praktikat më të mira të qeverisjes së korporatës.

Parime të Përgjithshme

Politika e Informimit dhe Transparencës e BKT:

- ❖ është në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Mbi transparencën për bankingun, produktet dhe shërbimet financiare” të Bankës së Shqipërisë dhe legjislacionit në përgjithësi;
- ❖ është artikuluar duke marrë në konsideratë praktikat më të mira të qeverisjes së korporatës;
- ❖ synon të sigurojë informacion korrekt, të saktë, të plotë, lehtësisht të arritshëm, të kuptueshëm dhe nën kushte të drejta për autoritetet përgjegjëse, aksionarët, investitorët e mundshëm, klientët dhe të gjithë përfituesit e tjerë;
- ❖ siguron që i gjithë informacioni i shpallur për publikun të jetë i kuptueshëm, i analizueshëm dhe i arritshëm me koston më të përballueshme në mënyrë që të ndihmojë në procesin e vendimmarrjes për të gjithë personat dhe subjektet që kanë për qëllim përdorimin e këtij informacioni;
- ❖ nuk rezulton në ndonjë obligim të njoftimit të publikut në respekt të informacionit në natyrën e sekreteve bankare dhe/ose në sekretet tregtare ose informacion i cili nuk është ligjërisht i lejuar për tu shpallur.

Mjetet e Informacionit

Për qëllime të informimit publik mund të përdoren mjetet dhe kanalet e komunikimit të mëposhtëm:

✓ Faqet web të Korporatës,

Faqet web të Korporatës (www.bkt.com.al dhe www.bkt-ks.com) përdoren në mënyre aktive me qëllim informimin e publikut dhe transparencën. Faqet web të korporatës përfshijnë informacion të detajuar dhe të dhëna rreth Bankës dhe deklaratave të tjera publike. Faqet web të korporatës janë strukturuar për të siguruar një akses më të shpejtë e të thjeshtë të informacionit për të gjithë të interesuarit. Informacioni i publikuar në faqet web është rregullisht i rinovuar. Siguria e faqeve web është siguruar nga Banka. Pyetjet, komentet dhe kërkesat e informacionit për të gjithë të interesuarit trajtohen nga Departamenti i Komunikimit të Korporatës në mënyrën më të shpejtë të mundur.

✓ **Deklaratat Financiare, Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Raporti Vjetor,**

Banka publikon periodikisht Deklaratat Financiare, Raportin e Auditorit të Pavarur dhe Raportin Vjetor. Këto material, përveç formës së shkruar që mund të gjendet në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës dhe nëpër degë, vendosen edhe në faqet web të korporatës.

✓ **Komunikatat për shtyp, buletine dhe konferenca për shtyp,**

Pas ngjarjeve të caktuara, lajmeve apo incidenteve me rendësi të lartë ose për lajmërimin e zhvillimeve të ardhshme, mund të zhvillohen komunikata për shtyp, buletine apo konferenca për shtyp. Këto organizime nevojiten të jenë në përputhje të plotë me materialin mbi Marrëdhëniet me Publikun të Bankës dhe dokumenta të tjera rregulluese. Informacionet në lidhje me komunikatat për shtyp, buletinet dhe konferenca për shtyp do të publikohen në faqen web të korporatës, masmedia, në publikimet e komunikimit të brendshëm etj.

✓ **Masmedia (TV, Radio, gazeta, revista etj),**

✓ **Internet (portale lajmesh, faqe të ndryshme etj.),**

✓ **Takimet informative, telekonferenca dhe videokonferenca,**

✓ **Takimet dhe prezantime me investitorë,**

✓ **Kanalet e Lajmeve (Reuters, AP, Bloomberg, etj).**

Personat e autorizuar për të bërë deklarata publike

Kryetari dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, Drejtori i Përgjithshëm, dhe Drejtorët e Grupeve janë të autorizuar për të bërë deklarata për shtyp, për media dhe për kompanitë e shpërndarjes së të dhënave në emër të Bankës. Departamenti i Komunikimit të Korporatës është në ngarkim të shpërndarjes së informacionit, komunikatave për shtyp dhe tipeve të tjera të informacionit të aprovuar.

Departamenti i Komunikimit të Korporatës do të trajtojë dhe adresojë tek Drejtorët përkatës të Grupeve kërkesat për informacionit nga të interesuarit.

Mbrojtja e Konfidencialitetit të Informacionit të Brendshëm

Bordi Drejtues është përgjegjës për të marrë dhe implementuar të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për të mbrojtur konfidencialitetin e të gjithë informacionit që nuk është bërë ende publik dhe që mund të ndikojë vendimet e investimeve nga investitorët potencialë.

Banka do të përgatisë dhe nxjerrë një listë të personave të autorizuar që kanë akses në informacionin e brendshëm. Përgjegjësitë e këtyre personave dhe arsyet e përfshirjes së tyre në listë duhet të shkruhen në mënyrë të qartë. Kjo listë do të rinovohet rregullisht.

Duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme në mënyrë që të sigurohen avokatët, prokurorët, auditorët e pavarur, këshilltarët e taksave dhe personat dhe subjektet e tjerë të ngjashëm që kanë akses në informacionin e brendshëm që ata janë përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni sipas ligjeve në fuqi kontratave të veçanta të ekzekutuara prej tyre.

Detyrimet dhe Ndryshimet

Bordi Drejtues është i autorizuar dhe përgjegjës për të ndjekur, monitoruar dhe përditësuar Politikën e Informacionit dhe Transparencës. Bordi Drejtues është i autorizuar të bëjë ndryshime në tekstin e kësaj politike dhe të gjitha këto ndryshime do të bëhen publike dhe publikohen në faqen web të korporatës pas dhjetë ditësh nga data e ndryshimit. Menaxhimi i Bankës është përgjegjës për të implementuar dhe vënë në fuqi këtë Politikë të Informacionit dhe Transparencës.

